



# NE, POPULLI



## DEMOKRACIA SOT

RREZE (14), REA (14), LEONIT (15), MUHAMED (14), DRENUSHA (14), ARLINDA (14)



### Ne kemi menduar për hapat drejt demokracisë së mirëfilltë!

Demokracia si sistem i qeverisjes ka filluar shumë herët, që nga koha e Greqisë së lashtë, ku ishte shfaqur në Athinë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë pushtet. Roli i demokracisë ka qenë i njëjtë sikur atëherë edhe tani, por qeverisja ishte përcaktuar vetëm me disa persona të zgjedhur. Çdo njëri prej nesh ka hasur në pyetjen „Çfarë është demokracia?“ Sa herë përmendet termi demokraci, gjithmonë na shkon mendja tek fjala „liri“. Demokraci do të thotë se i gjithë populli është i barabartë, dhe secili i ka liritë e veta, por duke mos ia cënuar të tjerëve lirinë e tyre. Për përcaktim më të sigurt të demokracisë duhet të bazohemi në të drejtat themelore të njeriut. Zbatimi i të drejtave themelore ndihmon që të kemi një demokraci të mirëfilltë. Ato i përcakton Kuvendi, ku gjenden përfaqësuesit e popullit ose ndryshe deputetët.

Pra, Kuvendi është pushteti legjislativ. Quhet kështu sepse krijon ligje, kurse ekzekutimin e këtyre ligjeve e bën Qeveria, pra pushteti ekzekutiv. Përveç pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, bën pjesë edhe pushteti gjyqësor, ku marrin pjesë gjykatat.

Barazia është një ndër elementet kryesore në demokraci, por përveç asaj janë edhe e drejta e jetesës, e emrit, e krijimit të familjes, e strehimit, e ushqimit, e shkollimit etj.

Demokracia shfaqet në dy forma: në atë të drejtpër-

drejtë dhe përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli merr vendime të drejtpërdrejta, kurse ajo përfaqësuese është kur vendimet politike merren nga përfaqësuesit e popullit.

Për zhvillimin e demokracisë në Kosovë na duhet që fillimisht të kemi një zhvillim ekonomik, arsimor, shëndetësor, duhet që t'i zbatojmë ligjet etj. Këtë zhvillim mund ta bëjmë ne, e ardhmja e këtij vendi.



Gazetarët gjatë punimit të artikullit



Autorët e artikullit

# EDHE TI KE RËNDËSI

ELION (14), VESA (14), YLLKA (14), VLERA (14), ANISA (13), DONAT (14)



## Sado pak që e mendon, edhe ti je i rëndësishëm në komunitetin tënd.

Fillimisht, duam të flasim për shprehjen e mendimit të lirë gjë e cila është ende problem në shoqërinë tonë.

Ne kemi të drejtën e shprehjes së mendimit, jetojmë në një shoqëri demokratike, kemi të drejtën e shkollimit për mësimin e gjërave të reja dhe jemi mendjekthjellur. Atëherë cili është problemi ynë?!

Duam të dalim tani në një temë tjetër, e cila ka pak a shumë përgjigjen e zgjidhjes së këtij problemi – ngacmimi i bashkëmoshatarëve.

Njerëzit në shoqërinë tonë ngacmohen për mënyrën e të veshurit, mënyrën se si flasin, mënyrën se si shprehen, gjëra këto që krijojnë pasiguri, probleme në vete dhe mendime të shumta që ata nuk kanë rëndësi në botë. Nga krijimi i kësaj pasigurie, shkaktohet edhe pasiguria e të shprehurit, duke pasur gjithmonë në mendje se nuk je i mjaftueshëm dhe se fjala jote nuk do të ketë kurrfarë vlere. Kjo duhet të ndalohet!

Ç'është qytetaria aktive për ne?

Qytetaria aktive nënkupton bashkëpunimin e qytetarëve të një komuniteti, qyteti dhe shteti së bashku. Bashkëpunimi midis njerëzve krijon fuqi më të madhe, dhe lehtëson bërjen e punëve, qoftë ajo ndonjë aktivitet, apo diçka tjetër .

Qytetaria aktive nënkupton:

- Pagesën e taksave
- Votimin
- Punën vullnetare.

Pagesa e taksave:

Si qytetarë të rregullt që jetojmë në këtë komunitet, bashkë me të tjerët kemi përgjegjësi që të ndihmojmë në formimin e shtetit tonë.

Votimi:

Çdo njeri, pavarësisht racës, gjinisë, moshës, fesë, kombësisë, mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votoj. Votimi është detyrë e çdo qytetari aktiv për të zgjedhur personat që i prijnë këtij vendi.

Puna vullnetare:

Është mundësia më e mirë për të qenë i dobishëm, për të ndihmuar në komunitet, për të fituar dije, dhe për t'u vetëdijësuar për qëllimet që kemi në jetë.

Puno, vepro, mëso gjëra të reja, shprehu, fokusohu në rritjen e qenies njerëzore e në këtë mënyrë do të bëhesh qytetar i devotshëm, duke bërë diçka efektive dhe afatgjatë për vendin tënd.

E ç'është më e rëndësishmja, do ta gjesh veten, e pa më tregoni, a ka gjë më të mirë se sa të diësh t'i përgjigjesh pyetjes: „Kush je dhe çfarë bën për kënaqësinë tënde , e cili është versioni yt i një bote më të mirë“?



Autorët e artikullit



# ZËRI I POPULLIT

ANISA (14), VALTON (14), ARIAN (14), SOKOL (14), VESA (14), DAFINA (15)

Funksionet e Kuvendit të Kosovës		
<b>Funksioni Përfaqësues</b>	<b>Funksioni legjislativ</b>	<b>Funksioni Kontrollit</b>
Kuvendi përbëhet prej 120 deputetëve. Funksioni përfaqësues dëshmton mënyrën se si funksionon në vendin pra e përfaqëson shtetin dhe popullin.	Demokracia dëshmton dëgjimin e këmbës, liri, qeverisje etj. Funksioni legjislativ miraton, shfuqizon dhe propozon ligje dhe të tjerë ligjvënës.	Me funksionin të kontrollit mbikëqyrjen e punës së qeverisë.

## Ne si gazetarë të rinj të Kuvendit të Kosovës kemi vendosur t'iu flasim për demokracinë si temë kryesore në vendit tonë

Demokracia është zëri i popullit. Që ky zë të jehojë dhe të dëgjohet më shumë, Kuvendi na ndihmon që fjala jonë të respektohet.

Kosova është vend demokratik me demokraci parlamentare. Kjo do të thotë se Kuvendi i miraton vendimet kryesore të vendit tonë. Në demokracinë parlamentare, populli zgjedh përfaqësuesit nga çdo komunitet që vendi ynë ka.

Gjithsej ne kemi 120 deputetë, ku ata para Kuvendit i shprehin pakënaqësitë e popullit të Kosovës. Përgjegjësia kryesore e deputetëve të Kosovës është shfaqja e problemeve që ne populli i Kosovës ballafaqohemi. Kuvendi ka për detyrë mbikëqyrjen e qeverisë.


Detyra tjetër e Kuvendit është miratimi, shfuqizimi dhe

propozimi i ligjeve. Kuvendi, sipas diskutimeve tona zgjedhë Qeverinë dhe Presidentin dhe përfaqëson shtetin dhe popullin. Kuvendi është organ ligjvënës, ku pas miratimit të ligjeve i dërgon ato tek Qeveria për t'u ekzekutuar. Kjo është detyra kryesore e Kuvendit. Kuvendi përbëhet nga përfaqësuesit e popullit, të cilët ndahen në pozitë dhe opozitë. Pozita përbëhet nga partia e cila ka fituar shumicën e votave dhe prej nga formohet Qeveria. Kurse, opozita përbëhet nga partitë të cilat kanë fituar më pak vota. Deputetët ose ndryshe përfaqësuesit e popullit kanë mandat 4 vjeçar. Kjo do të thotë se çdo 4 vjet, populli ka mundësi ta ndërroj pushtetin.

Greqia ishte vendi i parë që e kishte përdorur termin demokraci („demos“-populli dhe „kratia“-qeverisje). Demokracia në vitet e para të lindjes së saj ishte indirekte, ku populli në mënyrë indirekte merrte vendimet.



Ne, gazetarët e këtij artikulli



Shkrimet tona mbi Kuvendin


**Në vazhdim të këtij artikulli do t'iu flasim për deputetët e Kuvendit të Kosovës, për rolin që e kanë dhe ndikimin e tyre në organizimin e shtetit**

Deputetët apo përfaqësuesit e popullit kanë ndikim të madh në jetën politike të vendit. Çdo komunitet në shtetin tonë ka përfaqësuesit e tyre, ku ata mbështeten për reflektimin e pakënaqësive të tyre. Kjo ndodh sepse këta deputetë i përkasin këtyre komuniteteve. Në Kuvendin e Kosovës kemi disa komunitete jo shumicë të cilët përbëjnë 20 deputetë të këtij institucioni. Këta 20 deputetë iu përkasin këtyre komuniteteve jo shumicë: komunitetit serb, boshnjak, romë, ashkalinjë, goranë, turq dhe egjiptian.


Shembull konkret i zgjedhjeve parlamentare janë zgjedhjet e kryesisë së klasës sonë. Me votat e nxënësve ne kemi zgjedhur kryetarin, sekretarin, dhe arkatarin e klasës. Kjo do të thotë se demokracia gjendet kudo në vendin tonë. Ne mendojmë se roli ynë në demokraci është shumë i madh, sepse ne jemi ata të cilët zgjedhim qeverisjen dhe liderët tanë.



Grupi i gazetarëve gjatë shkruarjes së artikullit



Funksionet e Kuvendit të Kosovës sipas nesh



Partenon i mbushur me mendimet tona



Ja se si duken gazetarët gjatë punës





# INSTITUCIONET VENDASE TË PUSHTETIT

ADEA (13), EURON (15), ENIS (14), OLTA (14), RINESA (14), URTINA (15)



## Ndarja e pushtetit në Kosovë

Pushteti ndahet në tri kategori: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ndarja e pushtetit bëhet për arsye se secili prej këtyre institucioneve ka funksionin e tij të caktuar. Secili punon në mënyrë të pavarur, por në thelb institucionet e pushtetit janë të varura nga njëra-tjetra, sepse asnjëra nuk mund të funksionojë mirë pa tjetrën. Funksionimi i rregullt i secilës prej tyre bën që



ndodh edhe me pushtetin tonë. Kjo ndarje bëhet me qëllim të funksionimit sa më të mirë të vendit. Nga tërë kjo që përmendëm më sipër mund të konkludojmë se ndarja e pushtetit është vërtetë e nevojshme dhe shumë efektive. Një ndarje e tillë është frytdhënëse, sidomos për një shtet ku institucionet e pushtetit bashkëpunojnë në mes vete. Kosova ka demokraci përfaqësuese, prandaj të gjithë punojmë së bashku për demokracinë.

shteti të jetë i koordinuar, i fuqishëm dhe demokratik. Pushteti legjislativ ushtrohet nga Kuvendi, pushteti ekzekutiv nga Qeveria, ndërkaq pushteti gjyqësor nga gjykatat. Pushtetin legjislativ e përfaqësojnë deputetët, më saktësisht 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë qytetarë shumicë, kurse 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë. Në shtëpitë tona ne ndajmë detyrat tona. E njëjta gjë



Gazetarët e këtij artikulli

### PUSHTETI GJYQËSOR

Pushteti gjyqësor ndahet në 3 gjykata: Themelore, e Apelit dhe Supreme. Pothuajse të gjitha qytetet kanë gjykata Themelore, mirëpo Gjkata Supreme gjendet në kryeqytetin e Kosovës. Problemet të cilat nuk mund të zgjidhen nga Gjkata Themelore dhe e Apelit, dërgohen për zgjidhje tek Gjkata Supreme.

Gjyqësori ka për detyrë të funksionoj në mënyrë të ndarë nga dy pushtetet e tjera, në mënyrë që mos të ndikohet nga ato.

Gjykatat kujdesen për zbatimin e drejtë dhe të mirëfilltë të ligjeve në fuqi. Ato gjithashtu, në rast të mosrespektimit të ligjit, kanë për obligim të ndërmarrin masa në këtë aspekt. Gjykatat përbëhen nga: gjyqëtarët, prokurorët dhe punëtorët ligjor.



Një vizatim i Gjykatës Supreme.




Gjykata Supreme

### PUSHTETI EKZEKUTIV


Pushtetin ekzekutiv e përbën kabineti qeveritar, i cili përbëhet nga kryeministri, zv. kryeministrat, ministrat dhe zv. ministrat. Poashtu, kabineti qeveritar përbëhet prej 17 ministrave të ndryshme. Në mbledhjet parlamentare mund të marrin pjesë edhe ministrat.

Edhe ekzekutivi duhet të funksionoj në mënyrë të ndarë nga pushtetet e tjera. Projektligjet propozohen nga Qeveria, si dhe Qeveria ka për obligim ekzekutimin e ligjeve të miratuara nga kuvendi. Pra, Qeveria zbaton ligjet, pasi ato hyjnë në fuqi.

Kabineti qeveritar dhe kryeministri kanë mandat 4 vjeçar, ndërsa përfundimi i mandatit rezulton me ndryshimin e kabinetit qeveritar, gjë që zakonisht ndodhë edhe në vendin tonë.



Pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv



Qeveria





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)